



DITA IV BOTËRORE E TË VARFËRVE

Dita Botërore e të Varfërve, e themeluar në vitin 2016 nga papa Françesku, kremtohet çdo vit në të dielën e 33-të të kohës gjatë vitit.

Kjo ngjarje këtë vit realizohet për herë të katërt dhe ka temën me titull: “Shtrija dorën të vobektit” (krh. Sir 7,36).

MESAZHI I ATIT TË SHENJTË FRANÇESKUT

Urtia e hershme i ka vënë këto fjalë si një kod të shenjtë për t’u ndjekur në jetë. Ato jehojnë sot me gjithë peshën e tyre të domethënies për të na ndihmuar edhe ne që ta përqendrojmë vështrimin në thelbësoren dhe të kapërcejmë barrierat e mospërfilljes. Varfëria merr gjithnjë fytyra të ndryshme, që kërkojnë vëmendje ndaj çdo gjendjeje të veçantë: në secilën prej këtyre mund të takojmë Zotin Jezus, që ka zbuluar se është i pranishëm në vëllezërit e tij më të dobët (krh. Mt 25,40).

Le të marrim në duar Siracidin, njerin prej librave të Besëlidhjes së Vjetër. Këtu gjejmë fjalët e një mësuesi urtie që ka jetuar rreth dyqind vjet para Krishtit. Ai shkonte në kërkim të urtisë që i bën njerëzit më të mirë dhe të aftë të vrojtojnë në thellësi ngjarjet e jetës. E bënte këtë në një moment prove të fortë për popullin e Izraelit, një kohë dhimbjeje, zije dhe mjerimi për shkak të sundimit të fuqive të huaja. Duke qenë një njeri me fe të madhe, i rrënjosur në traditat e etërve,

mendimi i tij i parë që t’i drejtohej Hyjit për t’i kërkuar dhuratën e urtisë. Dhe Zoti nuk la që t’i mungonte ndihma e tij.

Lexo tekstin e plotë në www.vatican.va:

[EN](#) - [ES](#) - [IT](#) - [DE](#) - [FR](#) - [PL](#) - [PT](#)

MBËSHTETJA FRANÇESKANE

Zyra e Drejtësisë, Paqes dhe Integritetit të Botës së Krijuar në bashkëpunim me ekipet e DPIK-Media ofron një ndihmës për të shtjelluar Ditën botërore të të varfërve me katër metoda: të Ekologjisë integrale, një soditje të realitetit, një shoshitje duke nisur prej vëllazërisë, një angazhim prej samaritanitetit.

Gjatë Pontifikatit të Françeskut, karizma françeskane zë një vend të rëndësishëm në axhendën e përtëritjes kishtarë. “Shtrija dorën të vobektit”, emri i zgjedhur prej ipeshkvit aktual të Romës për të kontestualizuar ngjarjet e Hyjit në Umbria në shekullin XIII, propozon një referim antropologjik me qëllim që të mbrohet krijimi i cili rrezikon të shkatërrohet.

Për këtë arsye Dita Botërore e të Varfërve nuk duhet kuptuar si një ngjarje, por si një proces evolutiv. Nuk është një veprimtari kalimtare, që bëhet e pastaj harrohet; është një veprim i përhershëm që shprehet dhe kremtohet me jetën.

Shkarko ndihmësin (PDF):

[English](#) - [Español](#) - [Italiano](#) - [Português](#)

LAJME TË TJERA



Famullitari françeskan i refugjatëve

L'Osservatore Romano i 7 nëntorit të kaluar ka botuar artikullin mbi fra Luke Gregory, famullitar françeskan i ishujve të Rodit dhe Kosit.

Kthesa në jetën e fra Lukës ndodh pikërisht dhjetë vjet më parë, me shpërthimin e luftës civile në Siri. Shumë vetë ikin nga bombat dhe Rodi është një prej porteve më të sigurta e të afërta ku gomonet e të dëshpëruarve mund të zbar-kojnë. Do të arrijnë me qindra e pastaj me mijëra këto vite. Dhe do të gjejnë gjithmonë fra Lukën, edhe natën, për t'i pritur, për t'u dhënë të hanë e të pijnë, për t'i mbështetur.

[...]

Dhe përpjekjet e fra Lukës tashmë janë të njohura edhe jashtë kufijve të ishullit dhe rretheve kishtarë, duke fituar solidaritet, mbështetje si dhe mirënjohje. Për këtë arsye Presidenti i Republikës italiane, Sergio Mattarella, ka dashur ta shfaqë vlerësimin e vet për punën e fra Lukës me refugjatët, duke i dhënë titullin e Kalorësit të Urdhrit të Yllit të Italisë.

[...]

Ai çuditet për gjithë këtë famë: «Nuk ka asgjë të jashtëzakonshme në atë që bëj: mirëpritja e të huajit refugjat është një detyrë jo një meritë. Për të gjithë. Më mirë, kur të mbarojë kjo pandemi, programoni disa pushime në Rodi: ky vend është shumë i bukur, dhe ndoshta më ndihmoni pak».

Lexo tekstin e plotë në:
osservatoreromano.va



Papa i vë Paliumin Patriarkut të ri të Jerusalemit të Latinëve

Më 29 tetor 2020, Vatican News ka shpallur lajmin se pak para Audiencës së përgjithshme të 28 tetorit, në Sallën Pali VI, Ati i Shenjtë Françesku i ka vënë Paliumin Lumturisë së Tij Pierbattista Pizzaballa, Patriark i Jerusalemit të Latinëve. Ceremonia, e shkurtër, e thjeshtë dhe shumë simbolike, është zhvilluar në Kapelën e Shën Martës në Vatikan.

Më 24 tetor 2020, papa Françesku e kishte emëruar Arqipeshkvin Pizzaballa Patriark latin të Jerusalemit, duke e bërë atë Patriarkun e 10-të që prej rithemelimit të Patriarkatit latin, të bërë në vitin 1847.

Në përshëndetjen drejtuar dioqezës së tij, patriarku Pizzaballa ka thënë: «Paliumi na kujton se në Pagëzim kemi zgjedhur të marrim mbi vete zgjedhën e Krishtit, peshën dhe lavdinë e Kryqit, që është dashuri e dorëzuar vdekjes dhe përtej».

Burimi: vaticannews.va

Fretërit brazilianë kremtojnë dy vite Misioni në Kapaço, Itali

Më 14 shtator 2018 arritën në qytezën e Kapaços, Provinca e Salernos, fretërit brazilianë Ademir Francisco Matilde, Patrick Roberto de Souza dhe Pedro Neto Alves Lima, që i përkasnin Kustodies së Zembrës së Shenjtë të Jezusit.

Qëllimi i pranisë është ai që të çojnë përpara disa projekte me emigrantët, asistencë ndaj më të varfërve, të sëmurëve, duke u përpjekur të jenë një prani shpirtërore, mikpritëse, që u afrohet linjave drejtuese të papës



Françesku për të qenë Kishë në dalje, për të lënë rehatinë dhe për të qenë lajmëtarë të Gëzimit të Ungjillit. Misioni është bërë më angazhues kur, në korrik 2019, tashmë me arritjen e fra Flaerdi Valvasori-t, kanë marrë përsipër famullitë e Kapaços dhe të Montefortes.

Aktualisht shoqërojnë edhe Vëllazërinë OFS lokale dhe vazhdojnë projektet me emigrantët (ushqim, veshje, këpucë, orendi dhe nevoja të tjera të ndryshme private e bashkësiore të emigrantëve). Gjatë pandemisë, së bashku me Vëllazërinë OFS, kanë prodhuar edhe maska.

Argjentinë: Koncerti i Këmbanave

Më 30 tetor 2020 në Salta, Argjentinë, është zhvilluar koncerti i këmbanave «Hermanos Todos», një emër që aludohet në enciklikën e fundit të shkruar nga papa Françesku.


Koncerti i këmbanave është zhvilluar në seksionin e tretë të kumbonares së Shën Françeskut, ndërtuar në vitin 1882, e lartë 54 metra.

Koncertistët u kanë rënë këmbanave origjinale të vitit 1860 dhe Këmbanës së atdheut të vitit 1813, të drejtuar nga kompozitori, maestro Jorge Lehz, së bashku me anëtarët e Salta Symphony Orchestra dhe me orkestrën rinore të sapolindur.

E veçanta e këtij rasti është se u kanë rënë këmbanave të gjithë së bashku, për herë të parë në historinë e Saltës, në kontekstin e një ngjarjeje kulturore.

Përballë situatës pandemike që jemi duke jetuar, duhet të shpallim një mesazh shprese, paqeje dhe të kërkojmë bekimin e Hyjit që të mos jemi vetëm.

BOTIME TË REJA FRANÇESKANE



LAURA DIERKSMEIER, *Charity for and by the Poor: Franciscan-Indigenous Confraternities in Mexico, 1527-1700 (Bamirësia e bërë nga të varfrit dhe për të varfrit: Bashkëvëllazëritë indigjenofrançeskane në Meksikë, 1527-1700), University of Oklahoma Press, Norman 2020, fq. 238*

Bashkëvëllazëria u bë një institucion thelbësor për të mbrojtur popullsitë vendase gjatë epidemive, për integrimin e klasave të ndryshme indigjene të ish-perandorisë azteke në rendin shoqëror që po lindte dhe për mbikëqyrjen e vetëqeverisjes indigjene brenda sferës fetare. Në mënyrë krejt të veçantë, bashkëvëllazëritë e vendosura prej françeskanëve përbënë disa struktura shoqërore në të cilat të varfrit nuk ishin vetëm destinatarë të asistencës, por edhe, nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre vullnetare, veprues autonomë për të mirën e përbashkët. Në këtë mënyrë, bamirësia bëhej në të njëjtën kohë prej të varfërve dhe për të varfrit.




Felice Accrocca

FELICE ACCROCCA, *Francisco ayer y hoy. Vida y actualidad del Santo de Asís (Françesku dje dhe sot. Jeta dhe aktualiteti i Shenjtit të Asizit), Ediciones Franciscanas Arantzazu, Oñati 2020, fq. 162*


FRANCISCO AYER Y HOY
Vida y actualidad del Santo de Asís

Për Françeskun e Asizit është thënë gjithçka si edhe e kundërta e gjithçkaje, aq sa të jepej për të një imazh jo gjithmonë në përputhje me realitetin. Felice Accrocca na paraqet këtë përmbledhje artikujsh fillimisht të botuar në L'Osservatore Romano në të cilët trajtohet personaliteti historik dhe shpirtëror i Shenjtit të Asizit. Figura e tij trajtohet duke e tejkaluar anekdotiken dhe devocionalen, duke i kushtuar vëmendje të veçantë personalitetit të tij të veçantë dhe zemrës së përsheptërisë së tij: leximit të tij rrënjësor të Ungjillit. Për Accrocca-n kjo është përgjigjja ndaj aktualitetit të përhershëm të Françeskut. Në pjesën e fundit të librit bën një analizë të vizionit françeskan të Papës si edhe të Raoul Manselli-t, një ndër studiuesit më të mëdhenj të mesjetës në shekullin XX.



XAVIER SEUBERT OFM E OLEG BYCHKOV (nën kujdesin e), *Aesthetic Theology in the Franciscan Tradition: The Senses and the Experience of God in Art (Teologjia Estetike në Traditën Françeskane: Shqisat dhe Përvoja e Hyjit në Art), Routledge, New York 2020, fq. 408*

Libri heton teologjinë estetike të përfshirë në traditën artistike françeskane. Risia e kësaj metode gjendet në aplikimin e koncepteve të mbledhura nga burime tekstuale françeskane për të krijuar një kuptim më të thellë të asaj se si arti, në të gjitha format e shqisave, ka qenë në bazën e mjedisit françeskan. Kapitujt shtrihen prej studimeve të deklaratave mbi estetikën dhe artet në burimet tekstuale teologjike deri te shembujt e arteve të të parit, të të dëgjuarit dhe të të prekurit që komunikojnë ide teologjike të gjetura në tekste. Esetë kanë lidhje jo vetëm me artin evropian dhe burimet tekstuale, por edhe me ndikimet françeskane në Amerikë që gjenden si në tekste ashtu edhe në punime të dorës.



FIDEL AIZPURÚA OFM Cap, *«Hermano León, escribe». Escenas franciscanas («Frat Leon, shkruaj»). Skena françeskane, Ediciones Franciscanas Arantzazu, Oñati 2020, fq. 154*

Skenat françeskane që frati kapuçin Fidel Aizpurúa paraqet në këtë libër të vogël, në një pjesë të madhe janë të njohura për ata që në njëfarë mënyre kanë lidhje me françeskanizmin. Ka edhe disa prej tyre më të panjohura, por jo më pak interesante. Leximi që u bëhet këtyre skenave nuk është një lexim i përsheptë. Është një lexim i thjeshtë, elementar, i shkurtër që mban parasysht kërkimet e fundit mbi tekstet françeskane. Autori synon me këtë të hapë horizonte, të pasurojë kuptimin e faktit françeskan, të ftojë, nga ky lexim i shkurtër, që të nisë një hetim më i thelluar në linjë me atë që sugjerohet. Në fund të çdo skene gjejmë një "Shënim për përdorim" shumë praktik dhe baritor. Autori i këtij teksti identifikohet me dëshirën e Françeskut të shprehur frat Leonit: "Frat Leon, shkruaj". Kjo është ajo që është bërë me shije dhe devocion.

NGJARJE

SCORCI DALLA
TERRA SANTA



Mostra fotografica con gli scatti della fotografa e
amica Neva Gasparo

www.bibliothecatterraesanctae.org

EKSPOZITA ONLINE “PAMJE NGA TOKA E SHENJTË”

Ekspozita fotografike “Pamje nga Toka e Shenjtë” lind si gjest mirënjohjeje ndaj fotografes triestine Neva Gasparo (1951-2020) që gjatë qëndrimeve të saj të përsëritura në Jerusaleëm ka ditur të përjetësojë pamjet, fytyrat dhe panoramat më tërheqëse të Jerusalemit dhe të territorit izraelo-palestinez.

Neva ka bashkëpunuar me pasion dhe angazhim me Kustodien e Tokës së Shenjtë, me Terra Sancta Museum pranë Studium Biblicum Franciscanum dhe Bibliotekën e Përgjithshme të Kustodies së Tokës së Shenjtë.

Ekspozita online paraqitet me tre seksione (panorama, arkitektura e fytyrat) dhe përfshihet brenda projektit “Librat Ura paqeje”, të krijuar nga CRELEB i Universitetit Katolik të Zemrës së Shenjtë të Milanos në bashkëpunim me Kustodien e Tokës së Shenjtë dhe me shoqatën Pro Terra Sancta.

[Kliko këtu për të hyrë në ekspozitën virtuale.](#)



VIZITATORËT E RINJ GJENERALË

Fra Manuel Viera

i Provincës Shën Gjon Pagëzuesi, SHBA
për Provincën e Shën Barbaras, SHBA

Fra Wanderley Gomes de Figueiredo

i Kustodies së Shtatë Hareve, Brazil
për Kustodien e Zemrës së Shenjtë të Jezusit,
Brazil

Fra Hugh McKenna

i Provincës së Irlandës
për Provincën Shën Kazimiri, Lituani

Fra Andreas Brands

i Provincës së Shën Elizabetës, Gjermani
për Provincën I lumi Gjon Duns Skot, Francë
dhe Belgjikë

Fra Juri Leoni,

i Provincës Shna Ndou i Fretërve Minorë, Itali
për Komisionin Skotist, në Romë, Itali

AXHENDA E MINISTRIT GJENERAL

DHJETOR

1-24

Kohë personale e kushtuar
përgatitjes së Kapitullit gjeneral